



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 26.7. 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë; Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Luanda Domi, DCAF; Milot Rexhepi, DCAF; Visar Rushiti, GAP; Agnesa Haxhiu, KDI; Vesë Kelmendi, QKSS.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim rreth Planit të punës së Komisionit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim rreth Planit të punës së Komisionit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2016.

Kryesuesi- Duke iu referuar planit të punës, theksoi se Komisioni gjatë këtij sesioni (sesionit pranveror) ka zhvilluar aktivitetet e tij në bazë të planit vjetor të punës, i miratuar në fillim të vitit. Këto aktivitetet janë realizuar nëpërmjet mbledhjeve të rregullta, dëgjimeve publike, takimeve zyrtare, brenda dhe jashtë vendit dhe nëpërmjet vizitave zyrtare në institucionet përkatëse, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së tyre. Komisioni, gjatë periudhës janar- korrik, përfshirë edhe mbledhjen e sotme, ka realizuar 10 (dhjetë) mbledhje. Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë mbikëqyrur dhe monitoruar nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Ndërsa, sa i përket shqyrtimit të projektligjeve gjatë këtij sesioni, theksoi që nuk ka pasur në shqyrtim asnjë projektligj, edhe pse janë paraparë në Planin Legjislativ të Qeverisë dhe në planin e punës së Komisionit, për arsye se Qeveria nuk i ka sjellë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Komisioni gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar raportet vjetore për punën e institucioneve që mbikëqyrë: Raportin vjetor të komandantit të FSK-së për vitin 2015, raportin vjetor të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015, raportin e Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2015. Ndërsa, në Komision për këtë periudhë kanë raportuar:

- Ministri i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, në 1 (një) takim;
- Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, në 1 (një) takim;
- Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në 1 (një) takim;
- Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në 1 (një) takim.

Komisioni për këtë periudhë ka realizuar dy seanca dëgjimore, lidhur me zbatimin e strategjive si vijon: Strategjia Kundër Krimit të Organizuar; Strategjia Kundër Terrorizmit; Strategjia e Policisë e udhëhequr nga Inteligjenca; Strategjia Shtetërore për siguri kibernetike, mbajtur më 27 maj 2016;

Si dhe seancë dëgjimore për zbatimin e Strategjisë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, mbajtur më 31 maj 2016.

Komisioni ka realizuar dy vizita pune:

- Vizitë pune në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, më 26 prill 2016;
- Vizitë punë në stacionin policor në veri të Mitrovicës, më 27 qershor 2016.

Ndërsa, vizita jashtë vendit janë realizuar 2 (dy) :

- Pjesëmarrje e delegacionit të Komisionit në Konferencën për Politikat e Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së, në Hagë, prej 6 deri më 9 prill 2016;

- Pjesëmarrja e delegacionit të Komisionit në Konferencën për Politikën e Migrimit, Azilit, Shtetësisë në BE, në Bruksel, më 19 -21 qershor 2016.

Duke iu referuar planit të punës, konsideroi që pjesa më e madhe e aktiviteteve të planifikuara, janë realizuar, ndërsa ato të cilat kanë mbetur pa u realizuar do të barten në sesionin vjeshtor.

Rexhep Selimi- Konsideroi se situata e krijuar gjatë një viti në Kuvendin e Kosovës ka ndikuar edhe në punën e Komisionit, ndërsa pavarësisht kësaj, Komisioni ka qenë i gatshëm të bëjë edhe më shumë dhe se Komisioni është mbrapa me agjendën e paraparë në planin e punës, duke shtuar se nuk është faj i asnjërit nga anëtarët e Komisionit, por i Komisionit në përgjithësi, ku edhe mungesa e kryetarit të Komisionit dhe anëtarëve të tjerë, është zbrazëtirë.

Më tutje, theksoi që dy targetet e Komisionit për këtë vit kanë qenë, Projektligji për pensionimin e parakohshëm të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, si dhe hartimi i legjislacionit për ndryshimin e Komisionit të FSK-së, në Forcë të Armatosura, duke vlerësuar që Komisioni është i gatshëm të bëjë edhe më shumë, nëse Qeveria do të ishte e gatshme të procedojë projektligjet e tilla. Gjithashtu, konsideroi që Komisioni do të duhej t'i jepte një thirrje Qeverisë që Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, është i gatshëm të bëjë më shumë se sa ka sjellë Qeveria e Kosovës, prandaj duhet të shfrytëzohet sesioni vjeshtor për të plotësuar agjendën e prapambetur.

Nuredin Ibishi- Sa i përket ngecjes në realizimin e planit të punës, konsideroi që për pjesën e projektligjeve mbetet tek Qeveria, pasi nuk i ka proceduar në Kuvend, ndërsa sa i përket Projektligjit për pensionimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, konsideroi që është i domosdoshëm, pasi kemi një vjetrim të policisë, gjithashtu edhe Projektligji për komisionarin e Forcave të Armatosura dhe Projektligjin për transformimin e FSK-së, do të duhej të procedoheshin.

Ndërsa, sa i përket zbatimi të planit për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA), theksoi se në nivel qeveritar është formuar Zyra në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e MSA-së. Gjithashtu, edhe Kuvendi i Kosovës ka formuar Komisionin për zbatimin e MSA-së. Çështje tjetër është edhe plani i veprimit, lidhur me zbatimin e MSA-së, ku është formuar grupi punues, në kuadër të Komisionit për identifikimin e sfidave në sektorin e sigurisë. Më tutje, theksoi se çështje që ka mbetur edhe pa u përfunduar është edhe reforma në sektorin e sigurisë, si dhe masat që duhet të ngrihen lidhur me integritetin e pjesëtarëve, qoftë të Policisë së Kosovës, pjesëtarëve të FSK-së, si dhe aspekti i mbikëqyrjes financiare, çështjet e prokurimit, çështje të cilat do të përfshihen në planin e veprimit, pasi të harmonizohen qëndrimet e anëtarëve të Komisionit për këto çështje. Më tutje, vlerësoi se Komisioni ka kryer detyrat e ngarkuara, por çështja e asociacionit dhe demarkacionit ka bërë që të ketë një zhvillim më ndryshe, në kuadër të Kuvendit dhe se në pjesën e dytë të vitit duhet të bëhet më shumë.

Ganimete Musliu- Për realizimin e planit të punës së Komisionit, konsideroi që pavarësisht sfidave me të cilat është përballur Kuvendi i Kosovës, Komisioni ka arritur të ruajë frymën e punës dhe të gjitha mbledhjet e planifikuara janë realizuar dhe janë trajtuar çështjet me kapacitet të plotë. Ndërsa, sa i përket vizitave në terren, theksoi se kanë qenë pjesë e agjendës, duke veçuar vizitën në veri të Mitrovicës. Në mbyllje të fjalës, falënderoi stafin mbështetës të Komisionit për

punën e tyre dhe shprehu dëshirën, që në sesionin vjeshtor të bashkohen edhe pjesëtarët nga opozita, duke theksuar që sfidë mbetet mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.

Kryesuesi- Duke iu referuar fjalës së z. Selimi, theksoi se Komisioni nuk ka pasur ngecje, ndërsa sa i përket nëse mund të bëhet më shumë, ekziston hapësira. Më tutje, theksoi se Komisioni ka realizuar të gjitha takimet e planifikuara, por gjithherë është theksuar kërkesa për rikthimin e anëtarëve të Komisionit nga radhët e opozitës. Ndërsa, mos procedimi i projektligjeve në Kuvend, nuk është çështje e Komisionit dhe aktivitetet e caktuara, nuk janë varur nga angazhimi i Komisionit. Ndërsa, sa i përket çështjes së transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura, theksoi se si Komisioni nuk e di se çfarë mund të bëjë në këtë aspekt, pasi Komisioni ka qëndrim unanim për këtë çështje.

Rexhep Selimi- Theksoi se Komisioni ka kryer punën e vet, por Qeveria nuk e ka kryer punën e vet. Kjo do të thotë që Qeveria na ka lënë pa punë, duke ditur që asnjë projektligj nuk është proceduar në fushën që mbulon Komisioni. Më tutje, theksoi se Komisioni mund të përdor ndikimin pozitiv që të veprohet, në mënyrë që në sesionin vjeshtor të realizohet plani vjetor i planifikuar. Gjithashtu, theksoi rëndësinë e procedimit në Kuvend të Projektligjit për Komisionarin e Forcave të Armatosura, duke vlerësuar punën e bërë në atë projektligj.

Kryesuesi- Theksoi se sa i përket projektligjeve që nuk janë proceduar, arsyetimi i Qeverisë është që zhvillimet politike në vend, sjellja e opozitës kanë ndikuar që shumë çështje të ngecin. Ndërsa, sa i përket çështjes së transformimit të FSK-së, në Forca të Armatosura, si Komisioni jemi të gatshëm për të dhënë kontributin në këtë drejtim.

Nuredin Ibishi- Duke iu referuar rekomandimeve të dhëna pas mbikëqyrjes së Ligjit për Policinë e Kosovës, theksoi se i është rikujtuar edhe ministrit, si dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, zbatimi i tyre, të cilat do të mbikëqyren pas gjashtë muajve.

3. Të ndryshme

Kryesuesi- Njoftoi se letra mbështetëse për projektin e BE-së, sa i përket vazhdimin të projektit edhe për një periudhë tremujore gjatë kohës sa do të shqyrtohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, është proceduar tek Zyra e BE-së në Kosovë. Gjithashtu, njoftoi se nga z. Shkëlzen Syla, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së FSK-së, është pranuar një kopje e Planit të integritetit për Ministrinë e FSK-së 2016-2018. Gjithashtu, nga ana e z. Syla është dërguar edhe kopja e Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të MFSK-së për vitin 2015, si dhe Planin e implementimit të rekomandimeve. Më tutje, theksoi se nëse vazhdon agenda e Kuvendit, do të ftohet për raportim kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës, si dhe ministri i Ministrisë së FSK-së.

Ganimete Musliu- Propozoi që javën që vjen, të ftohet në raportim drejtorit i Përgjithshëm i Policisë ose zyrtarët përgjegjës për çështjen e trafikut, për të raportuar rreth gjendjes në trafik, pasi që ditëve të fundit ka rritje të numrit të aksidenteve dhe humbjes së jetës së njerëzve.

Kryesuesi- Propozoi që kjo çështje të ngrihet në Kuvend, si pyetje parlamentare.

Nuredin Ibishi- Shtoi që pasi të miratohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, do të ishte më efektive të bëhet kjo pyetje.

Rexhep Selimi- Theksoi se duke parë situatën në trafik, e cila është vlerësuar edhe nga raporte të ndryshme, si shumë kritike, për shkak të aksidenteve të shumta, konsideroi që nuk është arsyetim pritja e miratimit të ligjit, pasi Ministria ka kompetencën për miratimin e rregulloreve, që do të parandalonin këtë situatë.

Nuredin Ibishi- Shtoi se çështja se kush do të jetë përgjegjës për zbatimin e ligjit ka shkaktuar konfuzion, pasi që në rastin e Kosovës është Ministria e Infrastrukturës që është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për rregullat e trafikut.

Rexhep Selimi- Shtoi se prapë, përgjegjësia është e Qeverisë për të përcaktuar rregullat dhe jo e Kuvendit, prandaj duhet të merren masa nga cilado ministri, për të rregulluar këtë çështje.

Kryesuesi- Sa i përket çështjes së trafikut rrugor, shtoi se për këtë çështje do të duhej një mobilizim i organeve përgjegjëse, prandaj këtë çështje mund ta ngremë edhe në Kuvend.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku